

KIM MEHMETI
MIELL PËR BUKËN E NESËRME
TREGIME *dhe* NOVELA

BOTIMET TOENA

KIM MEHMETI

MIELL PËR BUKËN
E NESËRME

tregime *dhe* novela

BOTIMET TOENA

Botuese: Irena Toçi

Redaktore letrare: Aida Baro

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Gea Qëndro

ISBN 9789928960634

© AUTORI dhe BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

MIELL PËR BUKËN E NESËRME

Edhe sot kur baba im nuk është më mes të gjallëve, pres të më vijë dhe i ndrojtur të më këshillojë të kem frikë nga fjalët e thëna botërisht. I ndrojtur pra, e jo i frikësuar, sepse në sytë e prindërve të mi kurrë nuk e pashë as frikën nga vdekja e lë më atë nga të papriturat e kësaj bote.

Ata nuk ishin të trishtuar as atëherë kur, të qetë, prisnin ta braktisnin këtë botë. Mbase pse besonin se jeta është ëndërritje, e vdekja dalje nga bota e ëndrrave. Apo pse ishin të bindur se atje, e jo këtu në këto botë, njeriu i arrin të gjitha ato që meriton.

Nëna ishte e bindur se jeta e atjeshme e grave varej edhe nga mënyra se si i kishin shërbyer burrit në këtë botë dhe se burrat ishin sogjetarë të burgut shtëpiak të grave, por që e jetonin vuajtjen e të burgosurave. Ajo besonte se burri i saj është shtrat për fjetje, por edhe tabut që do ta çojë në varr, se ai mbante mbi shpinë themelet e shtëpisë, kurse ajo vetëm çatinë e saj, se themeli e mbante gjithë ngarkesën e ngrehinës familjare, ndërsa kulmi vetëm tjegullat që mund t'i marrë era, se ai mund ta rrëzojë shtëpinë e gruaja vetëm ta shpalojë atë, se këmbët e burrit janë jastëk, ku gruaja e vë kokën për së gjalli dhe ku do ta mbështesë atë pas vdekjes.

Ky besim i nënës më dukej i çuditshëm, por shumë, shumë njerëzor. Dhe, e dija se ky besim e ndihmonte të mos i ndiente prangat që atë e çonin të ecte nëpër oborr sikur të ishte e lidhur me një zinxhir, që nuk shkonte më larg se porta e lartë e avllisë, që duart të mos i shtrinte më tej se deri te kokat tona që i ledhatonte e të mos i çonte më lart se skajet e shamisë që duhej t'i lëshonte mbi fytyrë kur i kalonte pranë ndonjë burrë i huaj, apo t'i hidhte mbi kokë skajet e saj kur dilte në oborr për të mbushur ujë, apo kur priste ndonjë të afërm që sapo kishte hapur portën e lartë. Ata burra që nëna i përshkruante si “shtrat për fjetje e tabut për vdekje” mbetën të tillë gjatë tërë kohës ndërsa unë rritesha e ata plakeshin.

Me një kokëfortësi të paparë, ata bënë çmos që “bota e shkijeve” të mos kalonte assesi këndej portave të larta e të hynte në oborret e kullave të tyre, ku ata me përkushtim mbronin perandorinë e vetme që zotëronin – familjen e tyre. Ata e dinin se nuk do t'ia dilnin të mbijetonin vetëm duke siguruar bukën për familjarët, por duhej t'i mbanin gratë brenda avllive rrethuar me mure të larta dhe duhej të ushqenin frikën të “shkijet” se po i fole ndonjë gruajë pa qenë burri i saj në shtëpi, ti ke pranuar ta puthësh plumbin e dalë nga gryka e revoles.

Kështu ata ndërthurnin mbrojtjen e heshtur të burrërisë së vet me përkushtimin që të mbetet i paprekur nderi i shtëpisë. Apo thënë më qartë: ngaqë ata s'kishin si ta mbronin burrërinë e vet jashtë oborreve të kullave të tyre, mbrojtjen e saj e kishin ndërlidhur me qëndrueshmërinë e grave, të cilat

jetonin me bindjen se të ta shohë fytyrën i huaji, është njësoj si ta kesh çnderuar familjen.

Kështu, burrat e gratë e fshatit tim, jetonin të lidhur me një marrëveshje, e cila i detyronte që pjellën e tyre ta mbronin nga rreziku që u kanosej përtej avllive me mure të larta, matanë të cilave ata e shihnin mundësinë që fëmijët e tyre të tjetërsoheshin, ta harronin gjuhën e qumështit të nënës dhe të ëndërronin në gjuhën që do t'i shtynte të mos e mbanin mend se nga kishin ardhur dhe kush ishin.

Në këtë mbrojtje të vetvetes, gratë ishin ato që ruanin pastërtinë e gjuhës, të cilën e rrezikonin edhe burrat e tyre që punonin në Shkup, duke sjellë brenda avllive shprehje të huaja, që nuk i kuptonin gratë e tyre.

Prindërit, e veçanërisht nënat, nuk kuptonin shumëçka as lidhur me rendet shoqërore. Ata, ndërkaq, e dinin se s'të vlen gjë as kanuni as ligji, po mbete pa moral e ndershmëri.

Njëherësh ata e kishin të qartë se ka vlera njerëzore, siç janë besa e nderi, që nuk varen nga ligjet e kushtetutat e shteteve, por nga ajri, të cilin e ke thithur në kullën ku je rritur dhe ku pret të vdesësh. E dinin, pra, se sa më pak ka nder, besë e moral te njeriu, aq më pak ka njeri në të. Ata ishin rritur e ishin plakur në një mjedis e në një kohë kur shqiptarët e Shkupit dhe rrethinës e kishin të vështirë të mbijetonin dhe nga ata nuk pritej as të mendonin e le më ta thoshin mendimin e tyre.

Mbase pse u rrita pranë një nëne që gjithmonë i kishte sytë e përlotur si të ishin syprinë e kaltër e

liqenit, ku ishte mbytur dhembja e përbotshme dhe, duke u burrëruar pranë një babai që edhe pikëllimin edhe gëzimin i mbante si gjë të turpshme, që kurrë nuk duhej të shpreheshin para të tjerëve, unë edhe sot ndiej një lagështi të përhershme në sy dhe qaj vetëm në dhomën time të punës, aty ku nuk mund të më shohë njeri. Atë e kam si dhomë për dënësë ku, i vetëm, u lejoj lotëve të pikojnë mbi faqet e mia.

Aty derdh lot edhe ngase asnjëherë nuk e kuptova nëse im atë dinte të na donte aq sa nëna, apo njihte vetëm pikëllimin. Po ashtu, mendoj edhe nëse im atë dhe nëna tërë jetën e kaluan matanë gëzimit, nëse ata të dy mbetën banorë të vetmuar në bregun e pikëllimit e të frikës, në bregun e ngritur nga varfëria e kohëve të fëmijërisë.

Ja kështu, gjatë tërë jetës, prindërit mbetën si karrocë që bartte me vete peshën e rëndë të frikës së ne, fëmijët, do të bënim ndonjë gabim të tillë që do të kthente përmbys çdo gjë e do të na shpinte sërish pranë sofrës së varfërisë. Duke iu frikuar gjithaq skamjes që kishin përjetuar, ata dy aq e varfëruan jetën e tyre, sa edhe ditëve festive kur hanim drekën e Bajramit, nuk linin pa i mbledhur të gjitha thërrmijat e mbetura të bukës.

Babën tim e pashë të buzëqeshur vetëm mëngjesin kur e gjetëm të vdekur në shtratin, ku kurrë nuk ishte dergjur si i sëmurë.

Ajo buzëqeshje e lehtë në fytyrën e babait më dukej se ishte e qeshura që nuk na e dhuroi kurrë derisa qe gjallë. Dhe ai buzagaz i heshtur ishte bërë fole fluturash laramane, që dilnin nga aty dhe fluturonin mbi fytyrën e tij.

Unë mend shtriva dorën që t'i largoja ato flutura, të cilat përnjëherë e mbushën dhomën ku ai qëndronte i shtrirë në shtratin e vdekjes e ne rrinim kokulur dhe të heshtur pranë bregut të pikëllimit.

Pas njëfarë kohe, m'u bë se dyshe-menë e dhomës e mbuluan lulet dhe se ajo u shndërrua në lulishte, ku u lëshuan fluturat që dilnin nga buzëqeshja e babait.

Ku ta dish, mbase edhe më bëhej mua se kishte vdekur i buzëqeshur, apo se mbi fytyrën e tij fluturonin flutura laramane, ndoshta shihja atë që kisha dashur ta shihja sa që gjallë e që nuk ndodhi kurrë.

Po pra, mbase më fanitej se, tani që kishte vdekur, më në fund, po e shihte sa të bukura ishin fluturat dhe lulet ku ato ndaleshin, gjë që më dukej se kurrë nuk e kishte vënë re në të gjallë.

U ula pranë tij, ia ledhatova faqet, tashmë të çliruara nga ngërçi i përhershëm, ato faqe nga të cilat ishte larguar hija e brengave të shumta, që e munduan deri natën e fundit, kur ra në gjumë e nuk u zgjua kurrë më.

Ia sodisja rrudhat e fytyrës që tani nuk ishin të thella si një natë më parë, por dukeshin si shirita të bardhë të lëkurës, si gjurmë të një qetësie që i kishte munguar gjatë tërë jetës.

Dy rrudhat, të cilat mbase ishin nga të parat që i qenë shfaqur në fytyrë, ata dy përrenj nga ishin derdhur lotët e tij kur kishte qarë ende si i ri, larg syve të familjarëve, e që nisin nga buza e sipërme e shkonin deri poshtë syve të tij të vegjël, më kujtonin tim atë dhe ngjitjet e tij të përditshme fshatit përpjetë.

Ndërkohë më fanitej edhe nëna, që e priste te çardaku i kullës, ku ai i afrohej i heshtur dhe i dorëzonte miellin për bukën e nesërme.

Dhe porsa më ndërmenden prindërit që na siguronin bukën që kishte shijen e jetës, tërë të shkuarën time e mbulon bukuria e nënës dhe rreptësia e babait. Edhe tani, sa herë që kaloj Urën e Gurit të Shkupit, o më kujtohet babai me të cilin dilnim në qytet për të blerë teshë të reja për Bajram, o më ringjallet në kujtesë nëna me të cilën, të kapur dorë përdore, shkonim për vizitë te tezja e atje, ato të dyja bashkë kujtonin të atin dhe vajtonin për vuajtjet e tij.

Kur më kujtohen ato dy vajtojca me kokat pranë e pranë njëra-tjetrës, më shtohet bindja se as ka pasur dhe as do të ketë dy gra të moshuara si ato të dyja që ta duan aq shumë babanë dhe dashurinë ndaj tij kurrë të mos e mbulojë asgjë tjetër.

Kur e pyeta njëherë nënën pse vuante aq shumë për të atin dhe si ishte e mundur të mos kishte ditë që të mos lotonte për të, ajo më vështroi me ata sytë e saj të përplotur që ngjanin si qiell i kaltër i mbuluar me re të bardha dhe më tha: “Sepse ai kurrë nuk u ngi me bukë vetëm që të kishim ne çka të hanim!”

Kujtimet për nënën dhe babanë gjithmonë më përcjellin të njëjtën porosi, të cilën ma kumtonin edhe heshtja e babait edhe sytë e përplotur të nënës: se njerëzit që i duam e na duan vijnë e shkojnë, por në fund ne mbetemi të vetëm me pikëllimin tonë në shpirt. Vetmitari brenda nesh më kot mundohet t'i përgjigjet pyetjes: vallë, duhet të na dhimbsen ata që kanë ikur përgjithmonë, apo vetvetja që ende po

bluhet në mullirin e kohës, mes dy gurëve të kësaj bote?

Po, babai u plak dhe u largua nga kjo botë; unë u rrita, u burrërova dhe u plaka, por nuk ia dola ta shmang ndjenjën se ai nuk më donte sa fëmijët e tjerë. Madje, shpeshherë më bëhej se ai më ndiente si trishtim, si dështim të vetin, prandaj, edhe për dallim nga fëmijët e tjerë, qysh i vogël, më lejonte të largohesha nga shtëpia e të bredhja udhëve të botës, pa u brengosur se do ta humbja udhën diku. Ku ta dish, ndoshta, thellë në vetvete, ndiente diçka që kurrë nuk ma tha, por që lexohej lehtë në çdo grimasë të fytyrës së tij: atij i dhimbsesha. Siç iu dhimbsa ditën kur më mori përdore që të më çonte në shkollën matanë lumit e ku përfundimisht do të shtegtoja në një botë tjetër, që nuk kishte asgjë të përbashkët me atë ku u rrita – në botën e sllavëve të jugut.

Im atë kurrë nuk e ngarkoi nënën me çka do qoftë tjetër, përpos se të kujdesej për shtatë fëmijët, që u kishin mbetur gjallë dhe që duhej t'i rrisnin. Ndërsa nëna na edukonte e na mbikëqyrte, ai duhej të na ushqente dhe mirëmbante. Atë ai e bënte aq bindshëm, sa edhe shujtën e mëngjesit që ia jepnin në spitalin ku punonte si rojtar, nuk e hante, po na e sillte neve dhe ngopej duke na parë si gostiteshim duke ngrenë hajen e gojës së tij.

Kështu ne rriteshim si zogjtë e vegjël në fole, ku saktësisht dihet cili është roli i nënës e cili i babait. Rriteshim, ndërkohë që të dy njësoj na mësonin profesionin më të zorshëm – të bëhemi njerëz. Ata ishin aq të përkushtuar ndaj këtij profesioni, sa

familja jonë ishte shndërruar në shkollë të njerëzores, ku babai ishte mësuesi më i rëndësishëm dhe më i pamëshirshëm, duke mos na lejuar të braktisnim asnjë orë mësimi. Këtij qëndrimi i përmbahej me vendosmëri, duke mos e lejuar as nënën që, në emër të dhembshurisë së saj, të na shpëtonte nga duart e pamëshirshme të ushtruesit.

Dhe, jo se nuk ndodhte që babai të na dënonte pse kishim shpërfillur ndonjë nga mësimet e tij për njerëzoren, por thuajse gjithmonë nëna ishte aty që ta merrte fajin mbi vete, vetëm pse nuk mund t'i duronte lotët tanë. Ne jetonim me përkëdheljet e nënës dhe me aktrimin e babait, se atij fare nuk i dhimbseshim kur i tradhtonim mësimet e mirësjelljes.

Që të dy u larguan nga kjo jetë duke na lënë përgjithmonë të hutuar: si mundi nëna ta duronte gjithë atë dashuri ndaj nesh dhe si ishte e mundur që im atë ta përballonte tërë atë aktrim rreptësie, kur ishte një shpirt që gjithmonë lotonte nga frika mos na ndodhte ndonjë e keqe. Kështu, nëna e babai vdiqën e kurrë nuk e mora vesh nëse ata dy e vinin re atë ndarje të roleve sa i përket përkujdesjes ndaj nesh. Ndërkaq ata të dy e dinin fort mirë se çka i takonte të bënte secilit prej tyre që ne të kishim fëmijëri të rehatshme, sa dukej qartë se nëna e jetonte dhembjen për ne e babai, trishtimin. Nënës i dhimbseshim së tepërmi për shkak të të këqijave që mund të na ndodhnin, ndërkaq babanë e trishtonte rreziku se mos vallë do t'ia merrnim fytyrën dhe kështu do të jetonim mallkimin e të pafytyrit. Për këtë arsye, nëna tërë jetën e kaloi e mbështjellë nga një dhembje e heshtur e babai jetoi i kredhur në trishtim.

Sot, shpesh përmallohem për ato kohë të largëta që mbetën atje, në shpatet e Malit të Krojeve nga ana jugore e Shkupit. Prandaj, shpeshherë, ngjitem kodrinës përpjetë drejt gërmadhave që dikur ishin shtëpi dhe fole të ngrohta, ku ndërthurej dashuria e prindërve ndaj nesh dhe ajo jona ndaj tyre. Posa arrij në fshatin e lindjes, ringjallen në mua kujtimet e largëta që në prapavijë kanë lumin atje rrzëzë malit, si dhe lagjet e qytetit. Atje përtej, në veri, shihen edhe vargmalet që fshehin nga shikimi Kosovën.

Duke parë atë që pjell kujtesa e jo atë që duket, përnjëherë më vërshon ngashërimi dhe dëgjoj vetveten tek pëshpërit: “O Zot, do të jepja tërë këtë pak jetë që më ka mbetur, sikur të kisha mundësi, për një çast, t’i shihja e t’i puthja dy djemtë e mi të ndjerë”. Pastaj dëgjoj vetveten si përgjërohet e lutet: “O Zot do të jepja të gjitha të nesërmet që më kanë mbetur t’i jetoj, sikur të kisha mundësi që, edhe njëherë të vetme, ta puthja nënën dhe ta dëgjoja si këndon pranë pusit; sikur të mundja të ndieja dorën e babait si më përkëdhel dhe, me zërin kërcënues, më udhëzon që të mos e harroj të mirën që më bëjnë njerëzit, ngaqë e keqja, edhe ashtu, kurrë nuk harrohet”.

Dhe porsa i përfundoj këto lutje çmendurake, shoh si vijnë drejt meje të gjithë ata që më mungojnë. Vrapoj drejt tyre por assesi t’i arrij: ata mbeten njësoj larg dhe, nga atje ku janë, më thonë se mund të llafosemi, por vetëm duke qëndruar çdonjëri në bregun e vet - unë në atë të kësaj bote e ata në atë të botës së përtejme.

Dhe pastaj nis biseda ime me ata që më mungonin, me ata të bregut të përtejme, të cilët nuk i mundon as pikëllimi, as malli për ne që jemi këtu.

ZË QË E THËRRET VDEKJEN!

Ka një zë në mua që sikur e thërret vdekjen dhe që gjithmonë më rikujton se jeta është spirale që të tërheq drejt fundit të saj, një spirale që nismën e ka te dënësja e të porsalindurit dhe që përfundon me heshtjen e të vdekurit.

Ka, pra, një zë që e dëgjoj pandalshëm e që më kumton të vërtetën se jeta nuk është as vuajtje, as festë, por vetëm një lutje që e shpërfaq mirësinë tonë, është shpirtlidhje mes gjithë njerëzve të kësaj bote, është ftesë për të vjelë dituri, është ndërmendje se qefini nuk ka xhepa, është edhe shpresë se edhe në ditën e vdekjes do ta përjetojmë lavdin e lindjes: daljen nga terri në dritë!

Ai zë, edhe sot e kësaj dite, më rikujton se burrat e gratë e dikurshme të fshatit tim, jetonin të lidhur me një marrëveshje, e cila i detyronte që pjellën e tyre ta mbronin nga rreziku, që u kanosej përtej avllive me mure të larta, matanë të cilave ata e shihnin rrezikun që fëmijët e tyre të tjetërsoheshin, ta harronin gjuhën e nënës dhe të ëndërronin në gjuhën që do t'i bënte të mos e mbanin mend se nga kishin ardhur dhe kush ishin.

Në këtë mbrojtje të vetvetes, gratë ishin ato që ruanin pastërtinë e gjuhës, të cilën e rrezikonin edhe burrat e tyre që punonin në Shkup, duke sjellë brenda

avllive shprehje të huaja, që nuk i kuptonin gratë e tyre.

Prindërit, e veçanërisht nënat, nuk kuptonin shumëçka as lidhur me rendin socialist në të cilin jetonin, as nga demokracia që erdhi më vonë.

Ata, ndërkaq, e dinin se s'të vlen gjë asnjë rend shoqëror po mbete pa moral e ndershmëri.

Njëherësh ata e kishin të qartë se ka vlera njerëzore, siç janë besëlidhja, nderi e morali që nuk varen nga kanune e ligje, por nga ajri, të cilin e ke thithur në kullën ku je rritur dhe ku pret të vdesësh. E dinin, pra, se sa më pak ka ndërgjegje, besë e moral te njeriu, aq më pak ka njeri në të.

Po, ka një zë që ma rikujton edhe udhëtimin e largët dyzetepesë ditësh me babën tim me makinë për në vendet e shenjta myslimane, e i cili mbetet nga më të magjishmit.

Mbase pse, përveç tjerash, e njoha babanë ashtu siç nuk e kisha ditur se është dhe ashtu siç nuk arrita kurrë ta përshkruaja.

Thuajse gjatë gjithë udhëtimit ishte i heshtur dhe dukej se zhvillonte një bisedë të pandërprerë vetmevete.

Vetëm herë pas here më afrohej, ulej pranë meje dhe, duke më parë me ata sytë e tij të vegjël e vezullues, hamendej nëse duhej të ma thoshte atë që nuk ia lejonte burrëria, por që ia kërkonte babai brenda tij: të më falënderonte për këtë dhuratë që gjithmonë e kishte ëndërruar i varfri i dikurshëm.

Duke e ndier ledhatimin e duarve të tij që i dridheshin, i thosha: ti je tempulli i shenjtë i krenarisë

sime, prandaj gjithmonë i kam ëndërruar ëndrrat e tua, që i kishe trashëguar nga babai yt: të të sjell në këto vende të shenjta!

Po, po, është një zë brenda meje që m’i rikujton të gjitha, që nuk duhet t’i harroj kurrë. Si për shembull, sytë e lagësht të nënës që kishin një bukuri avulllore që fluskonte mbi fytyrën time si engjëll.

I dehur nga ajo bukuri mahnitëse, nuk mund të përmbahesha dhe sërish e përqafoja fort.

Nga frika se fjalët e mia do të mund t’ia ndiznin sërishmi zjarrin përvëlues për shkak se së shpejti do të vinte ndarja e radhës, fjalët që doja t’ia thosha asaj, ia pëshpëritja vetvetes: “O moj nënë, sikur mos të të doja kaq shumë, do të mund të jetoja më lirshëm!”

Kjo thënie m’u kujtua edhe ditën kur e përcolla për herë të fundit drejt varrezave të fshatit.

Ndërsa ecja pas arkivolit ku prehej trupi i saj, më bëhej se, aty pranë kufomës së pafrymë të nënës, prehej edhe dashuria e pakusht që ma dhuronte e të cilën kurrë më në jetë nuk do mund ta shijoja.

Dhe, për herë të parë, më dukej se ajo e kishte më lehtë se unë, se nëna, njëherë e mirë, i kishte flakur të gjitha brengat, se kurrë më nuk do të përballej me netët pa gjumë duke më pritur, se e kishte shkarkuar barrën e rëndë të të këqijave që kurrë nuk më ndodhën, por që atë e trishtonin.

Mbase për t’ia shpaguear këtë dhembje e lotim, kurrë nuk m’u shkëput ndjenja e fajësisë se ndoshta unë isha ai që ia shkurtova jetën.

Dhe askush nuk më ka pritur si nëna. Askush nuk dinte të më priste si ajo.

Nëna më priste ndryshe nga gjithë të tjerët, që më donin dhe që kishin mall për mua.

Netëve, kur nuk isha në shtëpi, ajo më priste duke e mbështetur kokën mbi dorën e majtë, ashtu siç e kishte mbështetur gjatë viteve kur kishte bërë gjumë duke u dhënë gji fëmijëve, që i lindte thuajse çdo vit nga një, që nuk i mëkonte vetëm me tambël, por edhe me ëndrrat e veta për të ardhmen tonë të lumtur.

Pritjet e saj qëndronin të mbështetura mbi shtyllën e netëve të pagjumësisë, net kur ajo shtegtonte në hapësirën që ndante ëndrrat dhe zhgjëndrrën, në hapësirën ku kishte thurur fole malli i saj për të më parë.

Dhe, ashtu e mbështetur mbi shtyllën e pikëllimit të saj ajo flinte, por nuk bënte gjumë. E lodhur nga pritja që të kthehesha sa më parë, ajo niste të bridhte nëpër ëndrrat e mia dhe andaj kur i hapte sytë, nuk e shihte dhomën ku qëndronte shtrirë, por hapësirat nga bridhja dhe ku e kujtoja me mall.

Po, askush nuk dinte të më priste si nëna se, nga frika se mos më ndodhte ajo që e trishtonte, ajo mbështeste kokën mbi dorën e majtë, mbyllte sytë dhe vinte atje ku ndodhesha unë.

Nga pritjet që mbase edhe ia shkurtuan jetën, në mua lindi një zë, të cilin e dëgjoj pandalë dhe m'i rikujton të gjitha ato që nuk duhet t'i harroj kurrë.

MOSHA E KUJTIMEVE TË LARGËTA

Ishte e pabesueshme sa shumë shokë më ishin qepur që ta festonim bashkërisht natën e Vitit të Ri. Madje më shkruan edhe disa nga ata që mendoja se nuk jetonin më në Shkup. Siç ishte Dini, me të cilin, në të ri, i mbyllnim dhe i hapnim kafenetë e qytetit, madje dinim biografitë e gjitha këngëtareve që zbavitnin pijanecët e qytetit. Pra, ne të dy ishim si xixëllonja që dilnim buzëmbremjeve e ktheheshim në shtëpi posa niste të gdhinte dita; ne ishim si rojtarë të natës nga të pagjumët.

– Eja, le të dalim si dikur! – më tha ai.

E refuzova, duke u kujdesur që të mos e lëndoja, duke i shpjeguar se ajo “si dikur” nuk ekziston më, se ka mbetur vetëm kujtesa dhe malli për atë që ishte dhe që ishim në të shkuarën. I thashë se më mirë do ishte të mos dilnim, ngaqë do dëshpëroheshim, posa të vërenim se ne nuk kishim nevojë për njëri-tjetrin ashtu siç ishim sot, por për ata të dy që ‘kishim qenë dikur’ e që nuk do të jenë kurrë më.

Atë natë, m’u shfaqën edhe disa shokë që nuk i kisha dëgjuar prej vitesh, gjë që më shtyu të dyshoja se mos ndoshta ata parandienin se, pas këtij fundviti, nuk do isha më mes të gjallëve, andaj edhe donin të më shihnin para se të shtegtoja në botën tjetër.

Pasi u rralluan cingërimat e telefonit që paralajmëronin shokun e radhës që më ftonte ta festonim bashkërisht natën e fundvitit, nisën lutjet e familjarëve që me ata ta gëzoja ardhjen e Vitit të Ri. Dhe sa më shumë më luteshin, aq më shumë më rritej dëshira të rrija vetëm në shtëpi, siç më rritej edhe shtrëngimi i prangave të bindjes se, sa më shumë njerëz ke rreth vetes, aq më shumë e ndien mungesën e syve që nuk do të të shohin kurrë më, mungesën e duarve që të kanë ledhatuar dikur e që i ke humbur përgjithmonë, pa të cilët jo vetëm ditët e rëndomta, por edhe ato festivet, të duken si lule to vyshkura që ua ndien erën, por nuk ua sheh bukurinë.

“Shkoni dhe më lini ta shijoj i vetëm gëzimin tuaj dhe pikëllimin tim!” - u thosha pa u treguar atë që do t’ua rrëfente jeta: se kur jeton moshën e kujtimeve të largëta, ti në të vërtetë frymon me të gjallët që i ke pranë vetes, por bisedon me ata që përgjithmonë të kanë braktisur. Pra, jeton me ata që ke dhe kuvendon me ndërmendjen e asaj që ke pasur dikur e që nuk do ta kesh kurrë më.

Më në fund, gruaja nisi të më shantazhonte me nipat e mbesat, duke më bindur se ata ishin mërzhitur pse nuk do të më kishin pranë. E vështrova i vrenjtur dhe thashë me vete: “Është e mundur që tani, në pleqëri, ta ketë harruar vesin tim, se lutjet, jo që nuk më zbusnin, por më bënë edhe më të vendosur që të mos lëshoja pe”. Thuajse e lexoi atë që mendoja, andaj u kthye kah fëmijët dhe u tha:

“Ejani të shkojmë e të mos e lusim, sepse ky tërë jetën e harxhoi duke i çuar inat vetvetes!”

Ndoshta ata ende nuk e kishin braktisur oborrin e shtëpisë, kur ndjeva pendesë pse nuk shkova me ta. Në të vërtetë, porsa shkuan dhe porsa dhomën e pllakosi qetësia, më mori me vete lumi i rrëmbyer i kujtimeve. Pra, porsa ata e braktisën shtëpinë dhe mbeta i vetëm, dhoma u shndërrua në kopsht, ku mbinin kujtimet. M'u bë sikur qilimin e kishin mbuluar fotografi nga më shikonin fytyra të njohura e të dashura, që përnjëherë nisën të bisedonin me mua duke më rikujtuar të shkuarën e përbashkët.

Dhe jo vetëm dyshemeja, por edhe muret e dhomës ngjanin në tokë nga dilnin krimba, minj, pa kurrizorë të të gjitha llojeve..., pra kujtimet që depërtonin në imagjinatën time dhe brenin kufomën e vetmisë.

Përnjëherë u ndjeva si i kapur peng nga britmat që vinin nga thellësitë e së shkuarës. Madje, nuk mund as të çohesha në këmbë e të hapja dritaret, ngaqë qilimin tani më nuk e mbulonin fotografi, por kullosa gjembore që m'i përgjaknin shputat.

“Ndoshta, kështu nis ajo që i bën pleqtë aq nevrinë dhe të bisedojnë me vetveten”, pëshpërta jo i trembur, por i habitur me atë që ndodhte me mua dhe rreth meje.

Pastaj përnjëherë, në mes të dhomës, pashë dy vogëlushë me një bukuri engjëjlore, të mbështetur njëri pranë tjetrit. Dhe posa desha t'u afrohesha që t'i përkëdhelja, ata u zhdukën si tinguj të freskisë mëngjesore. Ndërsa largoheshin të buzëqeshur, më rikujtuan netët pa gjumë që kaloja në mes të shkretëtirës, ku dhembja për ta e brente në mua çdo